



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2023:275415

Datë: 11.06.2024

Numri i dokumentit: 05810175

C.nr.1368/2023

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Avni Berisha, me bashkëpunëtoren profesionale Shpresa Haxhijaha Rahmani, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditëses V.Xh-Sh nga Rahoveci, të cilën e përfaqëson avokati D.M nga Prizreni, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale për Arsim, të cilën e përfaqëson avokati B.O nga Rahoveci, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, për shkak të kompensimit nga marrëdhënia e punës, vlera e kontestit 1,383.75 euro, jashtë seancës, me datë 11.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. HEDHET POSHTË si e palejueshme padia e paditëses V.Xh-Sh nga Rahoveci, në këtë çështje juridike, për shkak të ekzistimit të gjyqëvarësisë (litispedencës).

A r s y e t i m

Paditësja V.Xh-Sh nga Rahoveci, më datën 06.12.2023, në këtë gjykatë ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale për Arsim, për shkak të kompensimit nga marrëdhënia e punës, vlera e kontestit 1,383.75 euro.

Gjykata ka gjetur së paditësja Valbona Xhemajli-Shala, nga Rahoveci, për çështjen e njëjtë pranë kësaj gjykate me datë 13.11.2023 kishte ushtruar edhe një padi tjetër ndaj të paditurës Komuna e Rahovecit – Drejtoria Komunale për Arsim, për shkak të kompensimit nga marrëdhënia e punës, e cila evidentohet me numër të lëndës C.nr.1088/2023 (2023:247378). Gjithashtu gjykata ka gjetur së lënda me numër C.nr. 1088/2023 është në shqyrtim e sipër.

Gjykata pasi analizojë të dy lëndët C.nr.1368/2023 dhe C.nr.1088/2023, gjeti së bëhet fjalë për çështjen e njëjtë, mirëpo meqenëse lënda C.nr.1088/2023, është proceduar më herët dhe e njëjta gjendet në procedurë e sipër, atëherë gjykata vendosi ta hedhë poshtë padinë në këtë çështje për shkak të litispencës. Kjo gjykatë këtë padi e ka hedhur si të palejueshme duke u bazuar në nenin 391 pika c) të LPK-së sipas të cilit parashihet që “*Pas shqyrtimit paraprak të padisë gjykata me aktvendim e hedh poshtë padinë si të palejueshme po që se konstaton se: c) për çështjen e ngritur me padi ekziston gjyqëvarësia (litispendenca)*”.

Andaj, në bazë të gjendjes faktike dhe dispozitës së lartcekur si dhe duke u bazuar në dispozitat e nenit 391 al. 1 pika 3., të LPK-së, është vendosur sikur në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC
Departamenti i Përgjithshëm – Divizionin Civil
C.nr.1368/2023, më datën 11.06.2024

Bashkëpunëtorja Profesionale
Shpresa Haxhijaha-Rahmani

Gjyqtari
Avni Berisha

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi, pala e pakënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve pas ditës së pranimit të të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.